

BESART VARFI
NE
NOVELË POETIKE

BOTIMET TOENA

Besart Varfi

Ne

novelë poetike

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Ky libër u botua falë ndihmës së Institucionit Financiar AK-Invest.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Emil P. Asdurian

Korrektore: Arlinda Rrushi

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Në kopertinë: “Portreti i Berta Mendes” nga Abel Manta

ISBN 978-9928-235-88-6

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësia”, K. Postare 1420, Tirane

Tel: +355 4 22 40116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

Http://www.Toena.com.al

*“Afërditës,
Deas së dashurisë, bukurisë e krijimit,
që nga qielli zbret, si dritë, mbi një kreshtë vale...”*

I panjohur (700 p.e.re)

Përschendetje!

Ndoshta e njihni!

Ka shumë mundësi të jeni takuar te sheshi i madh me pllaka të mermerta në kryeqytet, apo diku ulur te pragu i parkut, që rrethonte monumentin e Heroit Kombëtar, përballë Kullës së Sahatit. Në bibliotekë, ku librat burgosen për t'i ruajtur si dëshmitarë të rëndësishëm gjyqesh të qenë dhe të paqenë? Në librari, te këndi i rrugës, që kohë e mbrapshtë a varfëria e zbrazën nga kërshëria? Ah, po, isha ai, i cili, sa doli nga porta e kafenesë, mbushur me të panjohur, që rrufisin lajmet e ditës sikur të ishin ndodhi nga një planet tjetër dhe që enkas bëri sikur harroi, se u kthye mbrapsht të shihte se ç'u bë me novelzën e tij, të cilën e la pas mbi një tryezë, me qëllim që të shihte nëse do ta merrte në dorë dikush dhe se kush ish ai që e mori?

Një si ju, lexues librash të harruar dhe të pluhurosur në ndonjë cep të humbur shtëpie apo nga shporta e atyre, nxjerrë për t'u falur. Jo, s'ishte shkrimtar, të shkruarit nuk të bën shkrimtar, por një rrëmihës faqesh të zverdhura dhe të venitura nga dhembjet dhe nga brengat e tyre. Një i papunë, a një i lodhur nga puna që bën, që për një çast, vetëm për pak, pati një ndjenjë gëzimi e u end me të dhe nëse lëçiti diçka të pandier më parë, më mirë për të. Një i paemër, me tjetër fytyrë, që mbuloi të tijën dhe mbeti askushi, në këmbët e një gjiganti të verbër që s'arriti ta shihte, se donte të ish i padukshëm. Apo një aktor i zgjedhur që prologun e shfaqjes reciton që të përgatisë publikun për atë që do të ndodhë më shumë në mendjet e atyre që vanë ta shohin. Se kush ishte, s'ka fare rëndësi. Atë rol mund ta luante kushdo.

Ç'është?

Aspak, një tregim i zgjatur me fillim dhe mbarim, por një pjesë në vazhdim, një ndalesë për të parë më me imtësi ç'ndodhi, as një krijim i mirëfilltë imagjinate dhe pse disa herë u mendua si i tillë, por një dritare e hapur në jetën e dikujt dhe po aq e vërtetë sa ç'është e vërteta e jetuar. Një ndërthurje, bashkëbisedim dhe bashkëvuajtje, dhe pse ndarë në qenie të ndryshme, në një zgjatje kohe, e cila s'matet vetëm me sekonda, orë dhe ditë, por me një shtrirje ndjenjash, me

degëzimet e tyre, në sjellje a gjendje shpirtërore, që lindën e lindin mendime në një varg të pafund, të lidhura ngushtë në ekzistencën njerëzore. Po, kohë ka. Ndodhi, diku aty nga fundi i viteve '70 dhe fillimit të viteve '80, siç tregohet nga ato që u shkruan ditë pas dite, disa herë në ditë; letra, poezi dhe aty-këtu disa biseda në tejkë (telefon), që u shndërruan në një gjuhë krejt të re, ku fjalët s'ishin më shenja a mbartëse mendimesh.

Vendi?

Në më shumë se në disa, njëkohësisht, dhe brenda trupash e mendjesh të njëjta të mbuluara me lëkurë dhe gëzof të ndryshëm dhe shkrirë e ndërruar te njëri-tjetri. Në një rendje dhe endje te një rrugë jete, kur të qenët si vetvete, jo pjesë e turmës, ish trimëri dhe përpjekje pa mbarim. Ikje dhe ardhje, tek i njëjti vend, përrua a shteg, si valët e një deti në baticë; nxiton të pushtojë gjithçka që mundet, se mos ia rrëmben qielli. A ndoshta jo, nëse ka vërtet vend shpirti?

Është dhe një rit dhe mit parësor mendjeje, ku ndërgjegjja dhe e kundërta e saj, nga kohët parahistorike, siç bëhen bashkë dhe ndahen të zemëruara, kur gjuha ish një mjaullimë, një klithmë vuajtjeje dhe gëzimi, ngopje dhe urie, e gjithçka tjetër e lidhur me to, dëshirë e pashpjeguar, më shumë se nevojë, domosdoshmëri dhe, gjithsesi, ndjenja më e ëmbël, në thelb jo vetëm e njerëzimit. Është historia e dy njerëzve dhe e një maceje. E asaj që, pas kaq mijëvjeçarësh, ka mbetur e pandryshuar, si të ish një perëndeshë e Nilit, ajo që ruante Pemën e Dijes dhe të Jetës, pjesa femërore e çdokujt. Siç është një kërkim i vetes brenda vetes, për të zbuluar thjesht dhe për të zhveshur nga çdo e tepërt, ndjesi dhe gjendje shpirtërore si të ishin fletë të saposhkruara të një rrëfenje nga Një mijë e një netët, se të gjithë, ata që ishin aty, u rruhdën e u pështollën sa u bënë një, pa e ditur, pa e kuptuar, pa pyetur nëse do të lindte edhe një herë agimi i lumturisë për ta. Rrinë shtrënguar, dhe pse nuk qe e gjitha ëndërr... ende.

Emil P. Asdurian

Prolog

“Nga mëri e lashtë lind kryengritje e re,
ku gjak s’pati duar qytetare të bëjë pis,
prej barqeve vdekjendjellëse të armiqve,
një çift, dashuruar yll-kryq, jetën nis,
ata fatkëqij që u përmbysën mjerisht,
ç’u prish dhe vdiq, grindjen e prindërve varrosi...”¹

Është kjo ndjesi se ma kërkoi shpirti? A për ty?
Ndoshta një zgjedhje përtej çdo përmbylljeje,
ku e panjohura e frikshme bëhet m’e dashur se vetja,
ku fatin turma e egër s’mund ta prekë,
pa shtytje fisi a histori të vjetër,
një t’ardhme të parathënë heq,
lidhje njerëzish, larg një zotërimi shteti,
idhullin t’i thyejë dëlirësi e pastër,
njëtrajtësinë e mërzitshme pa nxitje,
bashkëjetesën e rreme pa dashuri?

A një kthim pas në kohë të gjejë ç’dikur e mëkoi,
fuqiplotë në mbretërinë e ëmbël t’ambllit,
veten mohon, tjetrën, të tijën bën,
bujshëm thërret e shpërthen:
në sy me shkëlqim të ri,
n’ecjen mospërfillëse, kërrusur të mburojë,
në thellësi të mos shihet nga askush,
e shenjtë, e fshehtë,
shkruar me flijim, në vuajtje,
therje, djersë dhe rrahje,
ulërimë, gjumin zotëron dhe çdo të tashme të zgjuar,
magjepse dhe e vërtetë,
ajo shprishëse, çdo kështjellë përmbys,

¹“Romeo dhe Zhuljeta” nga Shakespeare.

q' e lirë të ndihet në shqetësimin e vet.
Çlirim i hyjnisë nga mishi i hyjit,
mendësi e lashtë e etjes në etje,
ëndërr mrekulli, se me tmerr parandien,
se një ditë hijet e tyre do të shihen mbi pyje,
det e pellgje, bedena dhe re,
të pamundurën u bën të kujtojnë,
jo, asnjëherë me drojë dhe
keqardhje...

të kuptojmë se liri ish e jo nëmë.

PJESA E PARË

KREU I PARË

Dita e parë

I

Ç'të them të bukur, në mos për një mendim,
e gjumë s'fle dhe kur vjen ëndrra
dhe aty sillet mbrapa syve,
erën tënde të sjellë,
buzët t'i hapë trupit tënd,
prekjen ledhatare të qetësojë
dikën¹, ndezur
me ankth shpesh
e më shumë të uritur
se vetëm ti
e zbut
atë thumb malli
që shqisa s'ka
e veç më shumë ngulet,
ah, me një tjetër, ah,
rënkon e
hyn më thellë

çdo herë, fund pa prekur.

Ç'të them të bukur, në mos për një mendim,
atë që s'ka t'ikur...

¹ Pasion.

II

Si çdo dëshirë e papërbushur
të mos zgjohet as në ëndërr,
gjumin e qetë të flejë,
kokë të mos nxjerrë
në dritën plot diell,
pamundësinë e saj çjerrëse
të mos ndiejë,
zhytur e mban në hi kohe,
në baltë parësore,
ku etje e uri u mbrujtën në një,
q'ajo farë q'erdh aty të mos mbijë,
në errësirë të thahet
e harruar.

E shpesh dy sy të mëdhenj të zi,
tinëz shoh të më shohin
në pritje,
një pikëpyetje lënë varur,
mbi çdo gjë, kudo ku shtrihen

të paditurën pse?

[DËSHIRË]

DITËLINDJE I

Ndjeva që jeta ime s'kish kuptim, bile edhe atëherë kur kujtoja se diç po bëja, si ai dikushi me të ardhme, s'isha aq entuziast. Se mos vetëm e imja. Këtë e mendova për ta marrë veten me të mirë, mjafton të hidhje sytë përreth, gjithë ato fytyra që e kishin të pamundur të qeshnin, ata sy të vagullt, në atë dritë të venitur, që mekej e dridhej herë pas here, duke menduar se, gjithsesi, më i mirë qe, se kandili i bërë me vaj e fitil pambuku, fije leshi nga mbulesa të vjetra ushtrie, sesa dikur. Kur ishte ajo dikur? Kur fillonte dhe mbaronte? Ajo gjysmë ngërdheshje, që buzëqeshjen s'e linte të dilte, me dhembje, flokët pak më të gjatë se një gisht nën bregun e veshit, pantallonat e qepura me porosi nga një dok i trashë dhe fare i zakonit, që të rrinin pas trupit, përpara dhe mbrapa, si të ishin të një toreadori, poshtë pak më të gjera se ato që vinin drejt, sa të mbulonin më shumë se gjysmën e këpucës dhe ajo muzikë që çirrej nga një kitarë elektrike, me një përzierje të përçudnuar nga një valle popullore me ritmin dhe melodinë e një grupi të kohës, të përtejdetit, duke mbërritur në bregun tonë, si mbeturinat e një anijeje të shkatërruar, përplasur në shkëmbinjtë e ishullit të përgatitur për luftë. Të gjithë e këndonin nën zë, e përgjonim dhe e kërkonim si të ish erë lirie!

Unë, si të mbijetoja atë trysni të brendshme, përpiqesha ta gjeja veten diku tjetër, doja të krijoja diçka timen, pa e parë askush tjetër; ta prekja, ta kuptoja, dhe ashtu pa ngjallur dyshim tek askush, ta lija të më pushtonte të tërin, me lumturinë e asaj arritjeje, profesionin tim. Ashtu do ta shihja të rritej, pa shprehje fytyre, pa ndryshime të ngjyrës së zërit, pa atë veshje përsosmërie, që i vesh çdo marrëzie ngazëllimi dhe dashuria, e aq më pak t'i përgjigjej shpërthimeve të mia për një përdëllim kënaqësie nën rrezet e disa dritave të largëta si yje, që binin mbi numra magjikë, ndryshe nga fjalët, më të vështirë për t'u kuptuar. Bukuria e ritmit, melodia, shfaqeshin në fund, në atë kuti të vogël ku mbyllej perla që u ngjiz në përlloraritje

të vështira e të provuara në çdo mundësi. Ata do t'i dukeshin kujtdo të zymtë, të pajetë, të ngurtë, muzgje vjeshte me shi shifrash, që binin në zbritje e ngriheshin fluturim në shumëzime, me asgjë më shumë se e vërteta. Ajo forcë e mbinatyrshme, që mizorisht mund të ndryshonte jetë njerëzish nga një podium nderi në një qeli të fëlliqur vetmie, një arrati ku s'të pranonte as vetja, braktisur nga të gjithë dhe nga ç'mendoje të ish synimi i jetës tënde, nëse i tillë do të quhej të bëje të njëjtën gjë, derisa të vdisje. Besomëni, për të u rreka t'i përkushtohesha, me një ide të ngulur në mendje, ku trupi bindej verbërisht dhe i bashkohej me përkushtim, aq sa ndalja veten para pasqyrës, ta shihja me krenari, si ai, prej të cilit pritej diçka e rëndësishme dhe që këmbëngulës ecën drejt atij fati të pashmangshëm. Thashethemet për veten më kishin ardhur në vesh për këtë "dashuri të padëgjuar" dhe të dyshimtë, si për çdo gjë që i shpëtonte të zakonshmes a të njëtrajtshmes, sa çonte në rrëfime vullnetare, edhe në vetakuzime, për t'i dalë së keqes përpara, lëre pastaj të tjerët, ata që emrin, veç emrin kishin ndryshe. Ky veçim, apo qelimbyllje, e shtonte më shumë mosbesimin, si të ishte një tjetër fytyrë komedie për të mbuluar të vërtetën, një vend ku pushteti i olimpsave vendoste çdo gjë për të "poshtmit". Eh, kush donte të ish atje, të paktën një shkallë më lart. As u dhashë rëndësi, e i lashë të më kalonin përbri; kokën e mbështolla në vete dhe pak te xhaxhai im, që ish shumë më i ditur e më me përvojë se unë, në këto punëra njerëzish, dëshirash të rrezikshme të çfarëdolloj dhe, siç ishte me duar dhe mendje të aftë, i zbërthente pjesë-pjesë, i pastronte e i vinte të punonin përsëri pa kërcitje e pa frikën se do të pengoheshin dhe do të bënin dëm. Ai, orakulli im, më tregonte se çfarë duhej të prisja, çdo të vinte më parë e çfarë më pas. Para syve kisha historitë e hidhura, se s'duhej t'i besoja, se më e pakta që mund të ndodhte do të ish një zhgënjim pa marrë asnjë shpërblim nga gjithë ç'ish "investuar" për të. Ndoshta kërkonte një fli. Fatin, më shpaloste para syve, si mjeku të sëmurit hap pas hapi, se çfarë do t'i ndodhë nëse nuk dëgjon këshillat e tij, pa harruar t'i thotë, më së pari, që ai vetë, mjek i mirënjohur e plot përvojë, është shpesh i pafuqishëm në atë që fati e nxjerr

nga thesi për ta çuar te të shumtit dhe në harresën e tyre. Një zgjedhje aspak e veçantë, tërësisht e rastësishme.

Është për t'u çuditur, po ta vësh re me vëmendje në historinë e njohur, e sidomos atë të shkruar, pavarësisht nga kush, që në çdo shekull diku, ka një rizgjim, i cili s'ish ai që pritej nga dialektika, kushtet shoqërore, niveli i deriatëhershëm i njohjes dhe faktorë të tjerë (udhëheqësit e lavdishëm), e kushedi se çfarë. Si ithtar i Da Vinçit, s'mund të lë pa përmendur epokën e tij, q'erdh, siç thonë, nga shfarosja e popullsisë, nga ethet bubonike, te shekulli i Rusoit, sipas mësimeve të së cilit u mundua të më rriste ime gjyshe, e plot shembuj të njohur. Në kohën time, nëse mund ta quaj kështu, në të fundit është tregimi im, gjërat ishin përzier në atë farë feje sa nuk kuptohej më ç'po ndodhte: plogështia që vidhte jetë, merrej për dinakëri; pavendosmëria, si zgjedhje urtie, e më shpesh për besnikëri ndaj mendërisë së përgjithshme dhe të predikuar, ndërthurje interesash në shkallën e pushtetit; dhe të menduarit logjik, në një dogmë me kufij ngurtësisht të përcaktuar, sa s'arrinte të depërtonte asnjë vështrim vdekatarësh, shkruar enkas për këtë popull të përzgjedhur. Instinktët e bishave të uritura, për të ngrënë më mirë, më shumë sesa turma, në dhunti mbijetese, me më shumë pasardhës të njëjlojtë për nga egërsia e mizoria. E, prapëseprapë, në mes të kësaj ngatërrese, ne, si të na kish mahisur një virus a insekt kryeneç, bënim të ngjiteshim diku lart e më lart, në një botë mbi re përrallash, në një kullë të fildishtë për nga bukuria, asaj që i kënduan poetët shekuj më parë, që i lëçisnim, kokëmbuluar nga frika se mos dhe hëna na shihte kur shkruanim ndonjë poezi për të, si dhe për ato shkëndija ndjenjash, që lindnin papritur aty-këtu si xixëllonja, se prisnin t'i vriste vjeshta. Ishte kjo rrekje së bashku me dëshirën për të qenë vetvetja që na ndryshoi, na bëri të ndihemi të veçantë. Brenda nesh, tashmë, ish dikush tjetër. Gjasat ishin që kjo dashuri së shpejti do të mbaronte, dhe pse me ngjyra rinie, faqepjeshkë, kthjelltësi si të ajrit, ndaj dhe duhej të mbyllej, të kyçeje brenda atyre mureve, në atë rrethinë muresh të bënte, si çdo orendi, detyrën e saj, një ingranazh që s'di tjetër të

bëjë, veç për çfarë u krijua. Ato që lexonim, që shihnin përtej, jo vetëm i morëm për të vërteta, por dhe si një mësim që duhej të shkundte këtë përgjumje bosh, qoftë dhe sikur të kërkonte një vetëflijim romantik, kalorësiak, për të vluarën, që ndërronte formë a rrëshqiste nga një trup vdekatar te tjetri.

I lodhur nga këto mendime, kisha shkuar në shtëpinë ku festohej ditëlindja e një shoqeje të gjimnazit. Siç ishte zakoni i kohës, edhe për brezin tim, tashmë të pjekur e jashtë bankave të shkollës, kjo ndodhi ishte një shpërthim dëshirash, por edhe një shfrim të mbyste brengat e ditës, ose të shmangte zhgënjimin e një pritjeje të gjatë, për ta shndërruar në një ngazëllim të pafre dhe në një zgjuarsi tallëse ndaj çdo gjëje të “ndaluar”, apo duke përmendur pjesë librash, që qarkullonin dorë pas dore brenda një rrethi të ngushtë, “të helmëtat”, pjesët që vinin në lojë qeverisjen perandorake, otomane, mesjetare dhe aspak ashtu siç shitej, sa dhe vetë s’e besonin. Aty lexoheshin poezi dhe disa bejte nga njëfarë autori, emri i të cilit ngjante me fjalën “kthe”, me mbiemrin “shpirt”, lojë kjo e fatit, por edhe e stisur.

“E njeh atë?”, më pyeti dikush, një siluetë e zbehtë, humbur në tymin e duhanit, që pinte i shkujdesur dhe më tregonte me kokë në drejtimin për andej ku rrinte ulur. Ajo! Me krahët mbështetur mbi gjunjë, me duart që mbanin peshën e atyre flokëve ngjyrë të thellë toke, dhe ata sy që herë silleshin pa kërkuar në turmën e zhurmshme dhe herë përdhe mendueshëm, sikur të mos ish fare aty, por diku gjatë. “Ku?”, pyeta. Aty ku çdo gjë nxitonte të vërtitej për të fundit herë në atë dhomë “pritjeje” dhe korridor, duke lënë takime, shkëmbim numrash telefoni, adresa a ndoshta premtime për t’u parë përsëri. Të gjitha ç’duheshin mbaruar, pijet dhe ajo copë ëmbëlsirë, ishin zhdukur me kohë dhe tani dilnin me frymën që i merrej goja dhe me bulëzat e djersës që vraponin nën sjetulla, në shpinë dhe në ballin e lodhur me një ndjenjë të pakuptimtë çlirimi... Nxitimthi, u nisa drejt saj.

III

Nën ballin e ngrohtë,
që zbehtë shkëlqen si muzg vere,
dy hapësira të thella pa fund, vlagën e butë
të mbrëmjes presin të lëshojnë,
nën një kreshtë mali të drejtë,
një buzëqeshje pulëbardhe
në ajër tutet t'i prekë ëmbëlsinë,
detqiell i përmbysur
dhe nën të, mjekër e imtë,
ndarë në mëdyshje,
një pyetje ngre:

Supet, vallë, ç'janë?

Dhe rend shikim' i etur të pyesë kudo
në këtë peizazh qetësisht të trazuar...

[PEIZAZH MENDOR]

IV

Ka disa gjëra të çuditshme,
që koha sado të mundohet t'i veshë,
me palë petkash gjithëngjyrëshe,
nuk ndryshojnë,
sado që njerëzit mbi to hedhin
pamje ndodhish të errëta
apo vegime të kthjellëta, fshehin pa kuptim
të ruajnë një qetësi të rreme shpirti,
mbeten të njëjta,
sikur rrymërrjedhës i thonë
“jo”, pa ndonjë arsye,
si sy, s'e shohin ç'duan,
aspak për të parë çfarë shpresuan,
por vetëm t'ishin ata, që qenien e saj fshikën,
ndër vete e mbyllën
ashtu siç qe e brishtë si fjollë tymi,
që mendja e sjell
dhe pa menduar...

Çudi të tilla kanë një emër,
që s'është emër,
as tjetër, si pyetjet pa përgjigje,
në jetën e shkurtër,
në çastin e ndërprerë,

ndoshta bash për këtë.

V

Do të doja të di a më mendon, ndoshta kur ecën diku
në një rrugë mes pemësh ku shkel dhe unë,
a ndoshta në një kujtim të fshehur
dhe papritmas ndalet pa filluar,
a kur kokën mbështet në gjumë
të më shtysh përtej
si djalosh i hedhur çamarrok të mos hyj,
si dikur kur t'u afrua e fjalë
s'guxoi të thotë,
me shpresën e një shikimi plot zjarr,
të gjitha t'i shpjegojë
se vetë s'mundi dot
dhe qepallat mbyll
për të mos më parë?

Do të doja të di dhe si, dhe kur,
si t'ish një trokitje në portë
a gurth lajmi q'u hodh në dritaren tënde?

Ah, sytë e tu të shoh të hapen,
të më ftojnë të ngjitem në
dritën që lëshojnë poshtë...

VI

Letrën që i dërgova shoqes tënde,
shpresoj q'ë kuptove, ish për ty.
Dhe ato vargje të belbëzonin të frikësuara,
mpakur nga një dhembje e pakuptueshme,
mungesën e pashpjeguar
dhe psherëtimat,
që në fund u tretën në erë,
ndoshta s'i dëgjove,
por s'ishin për të,
s'kish sesi,
se dhe ai shikim si rreze dielli që vetëm
për një çast sytë të preku e
në sup t'u ul
të pëshpëriste emrin tim

dhe ai fluturoi i trembur kur
buzëqeshjen të pa
e humb' i ikur
pa përgjigje...

Ah, ende pres të kthehet...

VII

Ç'mendon për të mjerin që të shkruan
për një ndodhi të shkuar, se dikur nuk pati
veç një ndjenjë, në një cep
u fsheh për t'u zgjuar i paditur,
pa pritur përgjigje në heshtjen
se kaq mirë e njeh,
sa t'arrij të kuptojë se s'qenë sytë e mëdhenj,
as flokët e rëndë,
supet e brishta a
butësinë e ëmbël si hije drite
q'e pa e nuhati
e iku me të, pa e pasur kurrë,

por pastërtinë e një shpirti
se ndoshta askujt s'ia tregoi
veç vetes...

VIII

Do të doja të shkruaja për arsyen,
e asaj që s'është aspak e menduar,
as për copëza letre zografisur me mjeshtëri,
dërguar a futur në një të çarë muri,
si lutje,
as si një tufë lulesh me ngjyra vjeshte mblodhi
të sillte një jehonë të saj,
jo përshtypje s'la, ashtu si pulëbardha
që krahët hap për fluturim,
se shiu bie pa u ndier apo ai që qiellin
mban peng me litarët e tij,
s'pati, se asgjë s'priti,
veç buzëqeshjes sate të butë
në ikje,
sytë të mos rëndohen nga asnjë vështrim,

ndoshta për atë, e cila vetë
ish kaq e brishtë,

veç ish,
se s'mund të rrinte pa rënë pikë-pikë...

IX

I shkretë ai që shkruan dy gisht letër,
dënohet po aq herë për ato që tha,
se mund të thuheshin më mirë dhe
ato të pathënat, thellë t'ishin ndier
dhe m'i mjerë, ai që lëçit poezi,
fjalët e bukura q'u panë, në këngë
të bien
ashtu, një nga një, në fshikullin e erës,
lulet e ndezura të veniten dhe përtej asgjë,
se vërtet mund të gjenin dhe më,

dhembje e dëshirës s'mbahet dot në dorë,
as zë s'ka,
si shpirtndryrë në errësi
dritën pret e s'ngopet,

a mbase një ndjenjëzë të çiltër, kokëvarur, turpëruar
që vetë iku të fluturojë
për tek aty?

X

Dhe të mendoj për at' pritje
që rend të më dalë përpara, petalet e një buzëqeshje
të më hedhë dhe pas t'i ndjek, ah, pa të arritur.

Dhe të mendoj, si dikur, më këmbë përpara teje,
ndoshta për të thënë një fjalë
që nga turpi i vet u mërgua,
në mall, për të dalë në ëndërr,
n'atë kohë të largët,
se aty rri ngujuar
të mos zgjohet... a ndoshta po?

Eh, i gjori!

Të shkruaj që paksa,
vetëm një grimë,
bri teje të ec,
qoftë dhe mbi valë resh.

XI

Nëse ëndrra do të ëndërronte
veten të shihte diku
ulur pranë,
kur rrethinat veniten në mjegull,
kur ajri peshë s'ka e as qiell,
qeniet ndihen pa u prekur
dhe era të mos kishte më frymë,

sytë e tu do kërkonte të baresë
dhe dorën tënde
të mbante shtrënguar

dhe më... asgjë.

XII

Sikur, ato “sikur” që ishin dikur të gjitha,
kanë kohë ikur,
me pasigurinë gur’ të rëndë,
dhe pyetjet pa përgjigje,
ëndrrën që gjumin mban zgjuar,
atëherë kur frika e mpak,
thërmija mbetnë pas si pluhur
mbi dikën q’aty do rrinte
pa lëvizur të priste atë pak,
brenda vetes,
si syth n’acar

me të pafajshmen sikur.

Prekjen të ndiej prej syve,
zënë në çdo psherëtimë fjale
të pyes deri kur?

Sa ende?

XIII

Sa do të doja që rrezja e parë e agut të hapej me sytë e tu,
e q'aty t'u pija ëmbëlsinë dhe pakëz butësi.

Sa do të doja, mendimin e parë, çoroditur
nga dritë e ditës q'erdh, në heshtje
i ndrojtur mbi buzët e tua.

Sa do të doja që fjalën,
q'ende s'është ngjizur ta shkruaj,
fluturimthi ta dërgoj,
të niset për tek ty,
klithmën e vet pa dëgjuar,

dhe në s'arrin, si shumë të tjera,
pezull do qëndrojë mbi det dhe tokë
pa mundur t'ikë,
ty do të presë
me durim e padurim...

XIV

Cilën të pëlqej, thuanë ti, cilën,
ndrojtjen tënde që s'do të humbë,
të më vijë pas, qafën butë mbi supe zgjat,
apo atë ç'kam përpara
dhe pasqyrën e shpirtit bëri të më këqyrë,
pa dert,
buzëqeshjen e porsaçelur,
pritshmërinë kokëfortë, plisin që lehtë frymë merr,
ndër gishta shkërmoqet pa klithmë,
për të më thënë se do dhe më,
ah, maturinë e brishtë
q'u mbështoll të mos shihej,
se më mirë duhet të më njihte,
hovdëshirën me krahët e marrë
që palosur asgjë si qetësoi,
aty gjej, ç'është m'e bukur,
m'e thjeshtë,
dhe në thelb m'e çmuar
si mundem për të, germa të lidh,

me ç'syri
syut i tha pa zë?

E prapë rrekem të kërkoj,
në më të mrekullueshmen që më fale...

t'asaj që vetja je
dhe askush tjetër!

XV

Ah, rendi e shkreta, rendi me vërtik
të mbërrinte para se floku i rëndë erën
të derdhë mbi shtrat,
ëndrrat në vete të ndrynte,
mjegullës së vagët t'i rrëmbente
ngrohtësinë,
përreth meje, yjet la të binin,
në natën ende me një fije drite,
por e mjera në kohë dot s'arriti,

dot s'erdh' buzët të t'i puthte, pak
e trembur, e shqetësuar, pa frymë

cicëron e veç
u këput...

... harruar n'atë varg.

[POEZI E VONUAR]

XVI

Sa do të doja, rreptësinë të dëgjoja në zërin tënd të struket,
vellon të heqë dhe si zogjtë tingull t'ëmbël
t'i japë agut, ende ditën pa përgjakur,
se e re duhet të lindë dhe me të t'endem në rrugët e fatit
në fluturim i lirë, belbëzimin e mundur
të mbaj në gji.

Sa dua ajo, urtë të më flasë, të më tregojë,
ç'ndien e ç'dhemb, për ç'nuk tha,
ndoshta dhe për asgjë, dhe për askënd, aty
të gjej ç'koha s'prishi, ç'mbet ashtu siç ish
dhe pa folur të më kuptojë, çdo gjest, veprim a fjalë,
çdo gjë me të s'u tret,

të më shohë, të më kërkojë...
dhe shumë më shumë kur
hesht,

kënaqësinë, vetëm të mos e ndiej.

KREU I DYTË

Dita e dymbëdhjetë

XVII

Se të shoh,
të përkulesh mbi mua,
me frymën e ngrohtë plot përkëdheli,
pa fjalë, veç pasthirrma që më ftojnë
të shtriqem e duart të ngre lart
erëmirën tënde të kap,
me putra kthetrafjetur të ftoj,
si t'ishe flutur, krahët
të drithëroje mbi mua,
drejt teje vij kokulur
e vështrimin ngulur në ato
buzë që drejt teje më thërrasin,

e jo, ku dua s'më lënë të hyj,
pa më ndalur fare pak
bishtin të ngre i lumtur
fërkohej pas atij trupi,
që në mendje pareshtur u end

dhe syzmadhuar, i uritur
“Mjau”

gjetkë të strukem
duke pritur zëthin tënd...

[MJAU]

XVIII

Ndoshta duhet të shkruaj dhe më,
mbase duhet të shpjegohem,
për çfarë s' duhet të ketë arsye
se s' është marrëzi, as një dëshirë e papjekur rinie,
as një mendim i rastit, bisht palloi,
sytë e pendëve të tregojë,
por thjesht, diçka si mihje toke prej një bujku,
q' i rrodhi nga duart si këngë fyelli
për gruan, me dëshirën ta mbante në krahë,
prekjen t' i dëgjojë të belbëzojë me përkëdheli
dhe ngrohtësinë t' i mbajë në duar,
asgjë të mos marrë,
veç të ndajë ç' ish e tij...

XIX

Ish një rënie, gur në ajër, pa pengesë,
një fluturim i marrë drejt diellit,
me krahë që s'qenë të mitë,
një gjoks pa brinjë, që lehtë mund t'i shkulej shpirti,
bark pa lëvozhgë që s'kish nevojë për thikë?

Ish afërsia, a largësi që nga vetja ka frikë,
ajo ngjashmëri që pa dashur tek unë ngule
me frymën e thellë,
ndoshta me sy, me zë a me rreze drite,
të njëjtën, megjithatë e ndamë, mbamë
dhe fort shtrënguam apo ajo,
që prej diku ngeli e paprekur,
rrënjë s'arriti të mbijë, as të çelë,
fëmininë mbyllur në një vath gëzimi
dhe përkujdesje,
për të mbrojtur na rrethon,
nga një fat i paracaktuar
mjerimi të panjohur,
në rresht, tullë në mur të turmës,
si ushtarë kallaji derdhur nga e njëjta formë?

Ish, ajo mbetur nga ai ujë deti,
njëlloj, në rrjedhë lëngu, si gufon nga plagë e hapur,
pikë loti.

[RËNIE]

Në shumicën e rasteve, të gjithë e kemi provuar atë gjendje dremitjeje, kur i fshehur në dhomën ku flije (jo vetëm e jotja), në gjysmëdritë, si të kishe harruar hapur televizorin dhe programet kishin mbaruar me kohë, nën zhurmën ritmike si të shiut, si mërmërima ndjellëse e një ninulle, kaloje para syve, për të zgjedhur me vetëdije, ndodhitë e ditës, një pushim të nevojshëm, apo më shpesh të shpëtoje nga gjendje të mprehta shqetësimi, dërrmuese dhe të vështira për t'u kapërcyer, ku dëshpërimi pi cigare këmbëkryq pranë “vatrës”, sjell në mendje gurët kilometrikë të jetës, nga ajo e shkuar, e cila duket e pafuqishme të ndihmojë dhe vdekja numërohet si mundësi zgjidhjeje, në përleshjen brenda dhe jashtë vetes. Unë s'kam nevojë edhe sot, të bie në atë kllapi kalimtare, për të kujtuar a rijetuar atë, apo çdo gjë që e lidhur është e saj. Po, e shoh syhapur, të gjithëgjendshme, si një majë mali edhe kur vetmia ia përul lartësinë dhe e përbalt me një mungesë të plotë dëshire.

Të gjithë tundeshin si të ishin një trup, në një rit parahistorik, në mesin e një salle ku mbahej ajo mbrëmje e gëzuar, që s'kish asnjë arsye tjetër, veç nevojës së një rinie të ndezur, që mezi kish pritur të mbaronte viti shkollor dhe rregullat ushtarake, për të shfryrë atë frymë të mbajtur gjatë që po e mbyste.

Muret lyer me gëlqere, aty-këtu rrjepur, ku nga baltë e tharë nxirrnin kokë flokët e kashtës, nën atë lustër të bardhë suvaje dhe bashkë me një grumbull rrobash hedhur në një cep, tregonin që shërbente si depo për repartin e tankeve, ku bënin stërvitje studentët e universitetit. Era e rëndë e vajgurit, i cili përdorej në uniformat ushtarake kundër parazitëve, pohonte edhe një herë këtë fakt të rëndësishëm. Disa parulla të kuqe,

të çngjyrosura, zbardhnin në dritën e ndërprerë aty-këtu nga hije që shkundesnin, hidheshin e përkuleshin gjithkund, s'arrinin të mbulonin të fshehtën e së vërtetës së tyre, dalë ngjyre. Dritaret e larta me kangjella të trasha hekuri tregonin me mburrje rëndësinë e tyre dhe të kësaj salle përmbytur në tym cigaresh dhe avullit lëshuar nga ata trupa të rinj, plot forcë, që valëvitej si një mjegull e imtë mbi liqenin e ndërtuar aty pranë. Tryeza të gjata shtrirë përmbys mbi njëra-tjetrën mbërrinin deri lart në çati, ndërsa stola me dru të palatuar në dy rreshta prisnin të uleshin të lodhurit nga marrëzia ngjitëse. S'kish vend për të gjithë, por kush pyeste. Vargje njerëzish suleshin jashtë sapo pushonte muzika, si të ishin peshq në rritje të detyruar. Ç'muzikë? Unë i parruar, i palarë për më se një javë, si në një gjendje eremie e meditimi të "shenjtë", kundër rregullave drakoniane, me një kyç hekuri, në vend të kryqit varur në qafë, i cili i përkiste një valixheje të rëndë druri të gjyshes sime, ku më parë mbahej një takëm i plotë lugësh e thikash, gjithfarë lloji, prej argjendi, që dikush i pat vjedhur kur kish mbaruar lufta; bashkë me një shok të kursit, një djalë i shkurtër me syze rrethi që mbahej për hokatar dhe pak si bejtexhi i çartur erotik, i binim me sa fuqi që kishim një zgjatimi tryeze, ndërsa Artani luante i vetëm melodinë me një kitarë elektrike të prodhuar "me forcat tona" dhe që na mbante zap sa herë përshpejtonim ritmin, që ngrihej dhe ulej me galop e nxiste si thirrje e egër këdo, të dilte në atë shesh lufte rrahur nga këmbët dhe djersa.

Aty e pashë të lëvizte e sigurt dhe ngadalë, duke tundur hijshëm pjesën e fundit të trupit, sa nga njëra anë te tjetra, duke kaluar përmes asaj zhurme të frikshme, me bishtin ngritur lart, si një flamur krenarie dhe trimërie me mospërfillje ndaj kësaj lukunie, që as i njihnte dhe as e njihnin, për të vjedhur një përkëdheli të rastit a ndonjë copë ushqimi çfarëdo, dhe

nëse as njërën dhe as tjetrën, aq i bënte, do të shkonte duke i besuar një thirrjeje të brendshme, që i dridhte mustaqet si të ish në errësirë, drejt atij tamburi të mbytur druri që thërriste si një tamtam lajmëtar. Dukej dhe zhdukej, ashtu si rëndom bën lloji i saj, pasardhës të Basetit, bijës së perëndisë Ra, Diellit, në festat e së cilës fundëshpinat e kolme të grave zbuloheshin e tundeshin epshëm nën hënën e varur mbi brigjet e Nilit plak për t’i rikthyer pjellorinë atij dhe gjithkujt. Erdh, m’u afrova, u soll qark disa herë. U fërkua pas këmbëve të mia, kroi kokën tek ato, mjaulliu përvaishëm dhe u zhduk s’di ku. E imët, e gjatë, e bardhë, me flokë të artë, fare e re, ende e pacenuar si priftëreshë e denjë magjish dhe çmendurish të mistershme.

Isha, ndoshta, i vetmi që hynte dhe dilte në atë rreth vallëzimi si të donte, zgjidhte dhe linte kë i tekej, e mbante në vallëzim për pak kohë sikur do të shkonte diku ku e kërkonte detyra e tamburistit të përkushtuar dhe vetëflijues. Vashat i shoqëroja deri te vendi ku rrinin ulur si një kalorës fisnik i vërtetë, me kënaqësinë e të qenët i njohur dhe i domosdoshëm. Më goditi me një vështrim të beftë, ndërsa po vallëzonte me një djalë, të hollë dhe të gjatë, nga kurset më të larta. Flokëdrejtë, ndarë me vizë të drejtë dhe ngritur anash lart, sigurisht, me gjithë të tjerat njëlloj, por me uniformë më të krekosur dhe me qafore të qepur me kujdes, që ndriste nga pastërtia. E vogël, filiz i ri ulliri i sapombjellë, balluket ngjyrë gështenjë të errët, dilnin pak nga kapela, ku çuditërisht e gjelbra dhe e argjendta përziheshin diku thellë. Pak më e shkurtër se unë, sa mund ta pushtoja të gjithën fare lehtë në krahët e mi. Gjithë qenia ime nga ai çast i thërriste vetes t’i fliste, me një cytje çmendurie për t’i shkuar pranë, bashkë me një frikë këputëse mëdyshjeje, që më mbante ngulur në vend me një pse pa përgjigje.

Nuk e di se si u afrova, sigurisht pa më parë, ndaloja kur vështrimi binte mbi mua, derisa i rashë rrethit qark për të

arritur aty ku rrinte ulur, diku përballë derës, në krahë të majtë pas asaj perdeje hijesh, në buzë të stolit, ngjitur me disa shoqe, te shtegu midis dy radhëve. I ndrojtur se mos gjithë kjo përpjekje do të shkonte për drej, një mundësi e humbur ende pa filluar dhe për të fshehur qëllimin tim aspak të mbrapshtë, ndaloja dhe përshëndetësia me këdo që më dilte përpara, shpesh duke kënduar të gjithë bashkë me zë të lartë, si shenjë përshëndetjeje dhe lamtumire. Ja ku jam, në fund të asaj rruge të mundimshme rrethuar e mbrojtur nga qiparisa siluetash, që rreken të pushtojnë qiellin prej gëlqereje, pranë saj. Jo tamam përballë, duke pritur një ftesë, qoftë dhe një shikim pyetës, por asnjë nga këto s'erdhi. U nisa ta ftoja për kërcimin e radhës, por muzika s'kish të mbaruar...

Flokët, si nga një dorë e padukshme, ranë papritur mbi sy, duke prerë në mes shikimin e shumëpritur, atë që mendoja se do të ishte përgjigjja e kalvarit tim dhe ajo tufë flokësh e mbyti, aty ku duhej të lindte. Zgjata dorën për t'u mbajtur tek ajo sepse ndjeva sikur po më ikte, se pa të do të rrëzohesha, por s'e arrita; sytë, po ashtu, shkuan larg meje. Ula kokën i mundur dhe i humbur, përpara asaj madone të Da Vinçit, ku mbarimet, vijëzat dhe këndet zhdukeshin në një përzierje ngjyrash, që shkriheshin te njëra-tjetra dhe bëheshin një me ajrin e me frymën e tyre që preknin çdo gjë, si të ishin rreze drite. Një ndjenjë e re më pushtoi e bashkë me të edhe një dhimbje e vagullt. Dikush kish mbërritur aty vërtik përpara meje; e ftoi dhe shkuan në mes të sallës. Ai shikim i munguar më shtyu, më theu edhe pse s'u përplas tek unë; fare mospërfillës. Ula kokën dhe një humnerë zbrazësie u shfaq përpara këmbëve. Diku thellë një e çarë, që mishi s'pati forcë ta mbyllte.

Jehona vinte tashmë prej së largu, melodia e këngës himn i asaj kohe "Let it be" dhe tej kodrat ngjyrë vjollcë të

thellë, rrinin si varg patash, sup më sup me njëra-tjetrën, diç fërshëllenin, ndërsa mbanin prej bishti rrugën e bardhë gjithë pluhur dhe përroin si kurriz peshku, diku në zemrën e atij reparti. Një copë hëne e re hidhte drite sa te njëri dhe te tjetri e pavendosur, ndërsa dritat u shuan që nata të ulej në fronin e saj të gjithëpushtetshëm. Sytë i shndritën zotërues për një çast dhe një mjaullimë e pakuptimtë vijoi sa u mek.

XX

Largësitë janë të çuditshme, veten hanë me keqardhje,
se njerëzit ndarë s'kunden tej t'i mbajnë,
se sado përpiqen, pamundësi të ngrenë, bien e rrënohen
nën një shikim,
në një tingull të butë
dhe në pluhur kthehen
n'erë, treten në puthje...

por edhe kur ajo s'vjen, një kujtim,
e pas një ëndërr,
shumë më shumë
se pafundësitë e tyre
ka vlerë...

dhe as sa gjykimi yt i rreptë.

XXI

Sikur të pres pas asaj porte të shfaqesh papritmas,
se prej larg, atje tej të ndiej,
jo se era e rrëzon nga supet,
as nga trokitja e hapit tënd,
q'ë njoh t'endet rreth meje
kur shtriquer dremis
në ngrohtësinë e asaj sigurie
që besnikëria jote më jep.
Jo, s'është koha, kur dielli shkruan në prag
a mbi valën e detit q'u vonua një çast,
s'ma thanë as pulëbardhat
me klithmat e tyre:

thjesht të ndiej,
ashtu si heshtja të më flasë,
me gojën tekanjoze,
se është diku thellë, e pasy,
në rreze të padukshme të sheh
të zbresësh pranë meje,

mjaullin me gëzim e endje,
n'atë portë ende të pahapur...

[TJETËR SHQISJE]

XXII

Të trokisja në portë, ta hapje
përgjysmë,
të më shihje e çuditur
se çfarë bën ky i marrë këtu,
dhe e di,
një shkëndijë qortimi do të shihja në ata sy
dhe pse të heshtur,
nuk do e pranoja si përgjigje,
se mbërrita aty për asgjë,
as të më ulësh në sofa,
pranë maces imcake të pastër,
të më kundrojë me kërshtëri,
por si dikur, kohë më parë,
ngritur më këmbë a ulur,
pa nxjerrë një frymë, pa rima e vargje,
do hesht,
ah, sa do të pres të më afrohesh
e diç të bësh
me hovin tënd të ndrojtur,
qoftë edhe një ledhë fëminore
a një cekje me gisht,

pse jo, një puthje vocërrake,
mbi atë ngurrim të shkelësh
me një arsye më shumë,
ndoshta më mirë,
pa asnjë...

XXIII

Nuk e di ç'ke gatuar sot,
por edhe fasulet e djeshme
do t'i ha me ëndje,
me pak vaj ulliri, nga ai
shtypur me këmbë dhe
erë deti fletësh t'argjendta,
me bukën e zeshkët, që ngjyrë
furre i dha dielli,
brumësinë e mjaltë q'u mbrujt aty
ta ndaj me duar e
pranë teje nga një
kupë vere mbushur përgjysmë
sytë e tu të pi.

Përshtypje s'më bën ç'do më vësh përpara,
por si udhëtar nga rrugë e gjatë
e humbi dhe i lodhur mbërriti,
kokulur do pres të më japësh
çfarë të duash dhe
pak kripë... nga ti.

XXIV

Shiko përreth.

Jo, jo, andej në anën e majtë,
as në zallin atje përtej,
ku guit një çafkë a një pulëbardhë
q'e vetme vjeshtën pret
dhe kokën tund në këtë dritësi, vera
la të harruar.

Nuk më sheh n'atë rreze, q'e vakët
mbyll qepallat si t'ish frymë,
fëshfërimën nuk e ndien
tek fryn në shpatulla e psherëtin
se të fshikë s'mundet,
nuk dëgjon ato buzë pa fund të mërmërinë, në valë
të ftojnë të vish siç di e t'u flasësh me gjuhën tënë
si të ishin kotele...

Aty jam,
ajo degë ulliri e ndrojtur mbi ty
e pangopur, të vështron e mundohet
të mbështjellë me hije.

Të lutem, sytë mos i hap,
as mos më thuaj se më ndien
veç lërmë të rri
pranë.

XXV

Nuk e di nëse pret si pres unë
një lajm, qoftë dhe një fjalë,
të thënë në heshtje e krahët
përpëlit të ikë nga ato duar
mendimi a arsye,
q'u rrudh e pasigurt
se s'diti,
nëse duhej e lirë symbyllur
të shtrihej në shtrat me një rënkim
nga një "ah, sikur!" lumturie në kthjelltësinë
ku dielli në krahë ta marrë

dhe fladit t'i rrëmbej puthje,
kokën të kthesh e në fytyrë pushin të prekë,
buzën e tharë nga ajo pritje,
e të thuash:
"Po".

XXVI

Përpos asaj, se dua të zotëroj,
shtrirë e dorëzuar,
veten lë të mih në trupin tënd,
në mish e kockë,
gjoks, shpatulla dhe bel siç dua;
ah, njëherësh dhe në kah të kundërt,
si një përmbushje, dikur ndier të më jepej
fli dhe o Zot, jo vetëm,
më bën të dehem, me lumturi më mëkoi
dhe në thelb të qenies më rriti, palëmbledhur,
shtrënguar në pjesën më të vjetër t'atij truri,
të pandryshuar, përlulshëm ta shpalos në prehër,
drithmën për ç'ndien n'ëndje,
qetësinë në ngrohtësi,
jetë më fal si m'i zgjedhuri,

me të dhe nën të, dhe i vdekur,
nënshtrohem se dua!

[ZOTËRIMI IM]

XXVII

S'e ke kuptuar, s'e ke ndier kur me sheh,
bebëzën hape brenda saj të hysh,
si hundën të lëmoj përmall me gjuhë,
si shpinën shtriq, në kotje,
ndërprerë si valë e humbur,
rrahjen, rreket të dalë q'andej,
kur me putra buzët përkëdhel
vesën t'u vjedh,
rreth qafës kulpë mijërrënjë
të shtrëngohem,
gjurmën e erës sime të ngul aty,
sa të trembet vetja;
bishti barkun e brumtë të godet,
si tambur i bie, retë të shtrydhë
ritmin thellë ta ndiej shpirti.
Hungërimë parësore,
urie, etje dhe përtej,
se mbretërim' i lashtë njerëzor,
këndë e menduar kur s'të kish,
çdo pjesë në ringjallje e shijoi,
e përgjoi, të shpërthejë në çdo por'
me të njëjtin hov gdhendi në qiell,
se s'ish në jerm i pavetëdijsëm,
mendër, me kallinë e çelur
luleyje kundërmon në çdo fije,
aspak stisje, as lëçitje arsyeje,
por diç që vetiu rrjedh,
gumëzhin dhe për të
nën zë gurgullin... hareshëm!

[MACE]

Pusullë:

Si je? Unë kam dalë për një kafë. I lexova poezitë. Më pëlqen që shkruan. S'të kisha njohur kurrë kështu. Të kam zili. Përqaftime.

XXVIII

Poshtë jam, në rrugën e ngurtë,
argjend shkëlqen në rrezet e agut,
në pusi te porta, pres
mëngjesin tënd të rrëmbej
ty të grabis nga vetja,
mbi gjokun e erës të hedh,
robinë,
fort në gjoks të shtrëngo
e fluturim mbi një vështrim
mbi det të shkojmë, vetëtimë
aq pranë
sa shkumë e mjelmët
të na ndjekë
e dielli me litarët e artë...

N'ishullin tonë të fshehtë,
në shpinë të tij mbi sytha vese,
dëshirë të pimë nga buzët,
e herë-herë

duart të shtrëngojmë
në heshtje.

XXIX

Fola dhe me gjitonen Ndrojtje,
dhe i tregova, i qava brengë,
në mundem vallë të flas si dua?

S'mundem natën e mirë të t'uroj, se Hëna
do fshihet e turpëruar dhe dritaren e yjeve do mbyllë,
derën e ëndrrave ku fshehtas do hyj.

I thashë të të thotë,
kur guriçkë në dritare të trokasë,
dilmë të më flasësh,
dhe me sy lart të më ngjitësh mbi pjergull
të shoh, dhe në do, një puthje dërgomë...

mos më lër të bie përdhe
m'i ngratë se i ngratë...

*P.s.: nuk vij si grekët e lashtë duke sjellë dhurata me mendje të
mbrapshtë, por si gjuhë poeti me fjalë të zgjedhura, një degëz
ulliri të dhuroj dhe veten fli për atë altar.*